REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL**
**NJESIA E PROKURIMIT**

# PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT "Plane mbarështimi për pyjet"

I mbajtur sot në datë 22.05.2025 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt **"Plane mbarështimi për pyjet"**, me fondin limit: 25,913,170 (njezet e pesë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh

Neni 39 pika 1 e Ligjit 162/2020 "Per prokurimin publik" i ndryshuar prashikon se: "*AK ne procedurat e prokurimit mbi kufirin e larte monetar, ne rast se vendos te zhvilloje proceduren e prokurimit pa e ndare ne lote duhet te parashikoje nje percaktim te arsyeve kryesore per kete vendim i cili behet pjese e dosjes se tenderit*."

Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", *(i ndryshuar)* parashikon shprehimisht se:*"1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote* ***sa herë kjo është e mundur.*** *Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

*2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale."*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Se pari Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme, sepse Bashkia Devoll, ne rastin e kesaj procedure, kërkon që për nevoja të punës të prodhojë, ruajë, përpunojë, shpërndajë ose transmetojë informacion nëpërmjet rrjeteve informatike, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit në përdorim ose në pronësi të saj. Ky informacion duhet të transferohet në mënyrë të sigurt dhe i pakompromentuar në kohë reale, për te lehtësuar veprimtaritë ditore dhe manuale ne pikat periferike. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekezekutueshme kontraten pasi eshte nje sistem kompleks dhe i perqendruar dhe ne pune zyre porsa dhe tereni.

**Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave** është një dokument bazë për mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave i hartuar sipas ekonomive pyjore, me punime terreni e zyre, për njohjen dhe marrjen e një sëre të dhënash për tokën, klimën, faunën, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj, si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të ndërthurura, të nevojshme për t'u implementuar në këtë ekonomi pyjore, për një afat kohor të përcaktuar (10 vjet).

Planifikimi afatgjatë i qeverisjes së pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare duhet të mbulojë të gjitha aspektet sociale, ekologjike dhe ekonomike per ekonomite pyjore, autoriteti ka zgjedhur qe porpos sa me lart kjo procedure te mos jete ne lote per arsye te koordinimit te AK me OE/BOE Fitues ne rakordim te dhenash dhe hartim dokumentacioni, pasi ndarja ne lote e ben shume me komplekse kete procedure per ta menaxhuar ne zbatim, per arsye dhe te metodologjive te ndryshme qe mund te kene OE/BOE Fitues.

Ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb shërbimi është i së njëtës natyrë. Në këto kushte, gjykojmë se realizimi i procedures në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij sherbimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me llojin e sherbimeve, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e sherbimitnë kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

**NJESIA E PROKURIMIT:**